UDHËZIM
Nr. 9, datë 2.6.2026

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË NJËSIMIT TË DIPLOMAVE TË INSTITUCIONEVE ARSIMORE TË HUAJA OSE TË NGJASHME ME TO, LËSHUAR NGA SHKOLLAT PRIVATE TË ARSIMIT TË MESËM TË LARTË, TË LICENCUARA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 3, të nenit 52, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Të përcaktohen procedurat për njësimin e diplomave të institucioneve arsimore të huaja ose të ngjashme me to, lëshuar nga shkollat private të arsimit të mesëm të lartë, të licencuara në Republikën e Shqipërisë.

2. Në këtë udhëzim termat e mëposhtëm kanë kuptimet, si vijon:

a) "Program ndërkombëtar" është programi i arsimit të mesëm të lartë i akreditуar nga një organizatë arsimore ndërkombëtare dhe i njohur ndërkombëtarisht;

b) "Institucion ndërkombëtar akreditues/certifikues" është organizata ose enti ndërkombëtar që akrediton ose certifikon programin arsimor dhe provimet përfundimtare;

c) "Njësim diplome" është procesi administrativ i barasvlerësimit të diplomës së një institucioni arsimor të huaj ose të ngjashëm me të, e cila lëshohet në përfundim të një programi të arsimit të mesëm të lartë të zhvilluar në një shkollë private të arsimit të mesëm të lartë, të licencuar në Republikën e Shqipërisë, që zbaton një program arsimor të aprovuar nga institucioni i huaj dhe që është e akreditуar nga një institucion arsimor jashtë vendit.

3. Diplomat e institucioneve arsimore të huaja që njihen në Republikën e Shqipërisë, janë:

a) diploma për programin "*International Baccalaureate Diploma Programme* (IB DP)" , i cili zhvillohet në institucionin arsimor parauniversitar privat që ka statusin "*IB World School*" dhe lëshohet nga *International Baccalaureate Organization*;

b) diploma për programet "*Cambridge International AS & A Level*", i cili zhvillohet në institucionin arsimor parauniversitar privat që akreditohet nga *Cambridge International Education*;

c) diploma për programin francez që zhvillohet në institucionin arsimor parauniversitar privat, të akreditуar nga Agjencia për Arsimin Francez Jashtë Vendit (AEFE), në përfundim të të cilit jepet diploma "*Diplôme du baccalauréat*".

4. Institucioni arsimor parauniversitar privat që ofron program ndërkombëtar duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të jetë i licencuar për ushtrimin e veprimtarisë arsimore në fushën e arsimit parauniversitar;

b) të ketë akreditim nga institucioni ndërkombëtar akreditues/certifikues, brenda afatit të vlefshmërisë të përcaktuar nga ky institucion;

c) të zbatojë kurrikulën, sistemin e vlerësimit dhe standardet arsimore të programit ndërkombëtar për të cilin është akreditуar/certifikuar;

d) të ketë personel mësimor të kualifikuar sipas kërkesave të programit;

e) të garantojë zhvillimin e provimeve sipas standardeve të sigurisë dhe integritetit, të përcaktuar nga institucioni ndërkombëtar akreditues/certifikues.

5. Institucionet arsimore parauniversitare private të licencuara, të depozitojnë në ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe në institucionin përgjegjës për shërbimet arsimore, dokumentacionin provues për plotësimin e kritereve, sipas pikës 4 të këtij udhëzimi.

6. Aplikimi për njësimin e diplomës kryhet në shërbimin përkatës të platformës qeveritare *e-Albania* dhe përmban formularin e aplikimit që plotësohet *online.* Aplikanti ngarkon në format elektronik (PDF) dokumentacionin e mëposhtëm:

a) diplomën që kërkon të njësohet në RSH, të shkarkuar nga sistemi SMIP me vulë elektronike;

b) listën e notave për vitet e kryerjes së arsimit të mesëm të lartë (transkriptin me nota ose dëftesat vjetore) të shkarkuara nga sistemi SMIP me vulë elektronike;

c) rezultatet e provimeve përfundimtare nëse ka, të shkarkuara nga sistemi SMIP me vulë elektronike;

d) fotokopjen e dokumentit të identifikimit (vetëm për shtetasit e huaj).

7. Njohja e provimeve përfundimtare të programeve ndërkombëtare:

a) Provimet përfundimtare të programeve ndërkombëtare të arsimit të mesëm të lartë, të përcaktuara në pikën 3 të këtij udhëzimi, njihen si të barasvlershme me provimet e Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë, për efekt të njësimit të diplomës;

b) Për qëllime të njësimit të diplomës, rezultatet e provimeve përfundimtare të përmendura në pikën 3 shërbejnë si bazë për verifikimin dhe barasvlerësimin akademik të arritjeve të nxënësit, pa qenë e nevojshme pjesëmarrja në Maturën Shtetërore;

c) Në përfundim të procedurës së njësimit, institucioni përgjegjës për shërbimet arsimore lëshon aktin administrativ të njësimit të diplomës, i cili konfirmon barasvlerësinë e saj me diplomën e arsimit të mesëm të lartë në Republikën e Shqipërisë, njësimin e notave me sistemin shqiptar të vlerësimit dhe notën mesatare të studimeve.

8. Procedura e njësimit të diplomës vijon me shqyrtimin dhe verifikimin e dokumentacionit nga Komisioni i Njohjes së Diplomave në institucionin përgjegjës për shërbimet arsimore. Kur aplikimi është i plotë, institucioni përgjegjës për shërbimet arsimore ngarkon në mënyrë elektronike vërtetimin e njësimit të diplomës brenda 5 (pesë) ditëve nga data e aplikimit.

9. Në rast konstatimi të mangësive në dokumentacion, institucioni përgjegjës për shërbimet arsimore njofton aplikantin brenda 3 (tre) ditëve nga data e aplikimit në adresën elektronike të deklaruar prej tij në formular, për plotësimin e dokumentacionit të munguar.

10. Brenda 3 (tre) ditëve nga data e marrjes së njoftimit, aplikanti ngarkon në të njëjtin aplikim/ose dërgon në adresën elektronike të institucionit përgjegjës për shërbimet arsimore dokumentacionin plotësues. Institucioni përgjegjës për shërbimet arsimore, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së dokumentacionit të plotësuar, ngarkon vërtetimin e njësimit të diplomës. Në rast të mosplotësimit të dokumentacionit brenda afatit të përcaktuar, shqyrtimi i aplikimit ndërpritet dhe praktika arkivohet duke njoftuar aplikantin.

11. Vërtetimi i njësimit të diplomës lëshohet sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

12. Vërtetimi i njësimit të diplomës përmban minimalisht elementet e mëposhtme:

a) emrin, atësinë dhe mbiemrin e aplikantit;

b) emërtimin e shkollës private të arsimit të mesëm të lartë të licencuar në Republikën e Shqipërisë që ka lëshuar diplomën;

c) datën e lëshimit të diplomës;

d) notat e njëvlershme me provimet e maturës shtetërore në Republikën e Shqipërisë;

e) notën mesatare të përgjithshme të njëvlerësuar sipas VKM-së për notën mesatare.

13. Institucioni përgjegjës për shërbimet arsimore është institucioni përgjegjës për mbajtjen dhe përditësimin e regjistrit zyrtar të njësimit të diplomave. Regjistri mbahet në format fizik (*hard copy)* dhe elektronik.

14. Ky shërbim aplikohet në formë shkresore deri në përshtatjen dhe përfundimin e zhvillimeve teknike për pranimin dhe trajtimin *online* të aplikimeve në sistemin *e-Matura*.

15. Nxënësi që studion në institucionin arsimor parauniversitar privat, që ofron program ndërkombëtar mund të kryejë edhe provimet e Maturës Shtetërore dhe nuk pajisen me njësim të diplomës.

16. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Arsimin Parauniversitar në Ministrinë e Arsimit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, si edhe shkollat private të arsimit të mesëm të lartë, që zhvillojnë mësimin edhe në gjuhë të huaj, të licencuara në Republikën e Shqipërisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT
Mirela Kumbaro Furxhi

Shtojca nr. 1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Nr. prot. ____, Tiranë, më __.__.____

VËRTETIM NJËSIMI

Vërtetohet njësimi i diplomës së arsimit të mesëm të lartë, për z./znj. _____ (emër atësi mbiemër), ( ), lëshuar nga _____ (institucioni i arsimit të mesëm të lartë, i licencuar në Republikën e Shqipërisë që ka lëshuar diplomën), më datë __.__.____ (data e lëshimit të diplomës), lloji i arsimit të mesëm të lartë _____, nota mesatare e të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë _____, notat e njëvlershme me provimet e maturës shtetërore në Republikën e Shqipërisë, _____, nota mesatare e provimeve të maturës, _____, nota mesatare e përgjithshme e njëvlerësuar sipas VKM-së për notën mesatare.

Bashkëlidhur këtij vërtetim gjendet tabela e konvertimit të notave me maturën shtetërore dhe nota mesatare.

Kjo diplomë njësohet si _____ në Republikën e Shqipërisë.

Nota mesatare e të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë:		**---**	**(nota me fjalë)**
Notat e njëvlershme me provimet e maturës shtetërore në RSh:			
Nota D_1	Gjuhë shqipe dhe letërsi:	--.--	**(nota me fjalë)**
Nota D_2	Matematikë:	--.--	**(nota me fjalë)**
Nota D_3	Gjuhë e huaj (--):	--.--	**(nota me fjalë)**
Nota Z	Lënda me zgjedhje	--.--	**(nota me fjalë)**
Nota mesatare e provimeve të maturës:		--.--	**(nota me fjalë)**
Nota mesatare e përgjithshme, e njëvlerësuar:		**--.--**	**(nota me fjalë)**

Z./znj. Emër Atësi Mbiemër nuk ka detyrime të Maturës Shtetërore.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM